



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS M.

Numri i lëndës: 2022:220497

Datë: 02.10.2024

Numri i dokumentit: 06243409

P. nr.163/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË M. - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtares ligjore Alberitë Bibaj, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me Nd.nr.31/2024, të datës 05.09.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.890/2022, të datës 19.10.2022 kundër të akuzuarit N.I.M.nga fshati D., Komuna e M.s, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, dhe nenit 2 par. 2, 8, 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), **më 02 tetor 2024, nxjerri këtë:**

A K T V E N D I M

I. MIRATOHET marrëveshja me numër Nd.nr.31/2024, të datës 05.09.2024 e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në M. ndërmjet të akuzuarit N.I.M.nga fshati D., Komuna e M.s, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe të dëmtuarës K. – të cilën e përfaqëson me autorizim Arjana Mula, në anën tjetër.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.890/2022, të datës 19.10.2022.

III. PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit N.I.M.nga fshati D., Komuna e M.s, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.890/2022, të datës 19.10.2022, kundër të akuzuarit N.I.M.nga fshati D., Komuna e M.s, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata më 15.07.2024, e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë e duke vepruar në bazë të nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Institutin për Ndërmjetësim në M..

Më 05.09.2024, në Qendrën për Ndërmjetësim në M. është arritur marrëveshja Nd.nr.31/2024, në mes të palëve në procedurë. Andaj gjykata duke vepruar në bazë të dispozitës së nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin më datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data **02 tetor 2024**, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morën në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2,15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË M.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.163/2022, më 02 tetor 2024**

**Zyrtarja ligjore,
Alberitë BIBAJ**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.